

I BAZA LIGJORE DHE PROCEDURA E NDJEKUR PER SHQYRTIMIN E APLIKIMEVE:

- 1- Enti Rregullator i Energjise, ne zbatim te neneve 9 dhe 26 te Ligjit Nr. 9072, date 22.05.2003 “Per sektorin e energjise elektrike“, te ndryshuar, dhe neneve 18, 20 dhe 21 te Rregullave te Praktikave dhe Procedurave te ERE, miratuar me Vendimin nr.21, date 18.3.2009, pasi mori ne shqyrtim aplikimet e paraqitura nga KESH sh.a., TEC Vlore, OST sha. dhe CEZ Shperndarje, *me Vendimet e Bordit te Komisionereve nr. 62, nr.63, nr.64, nr.65, nr.66 te dates 13.09.2010*, vendosi fillimin e procedurave per percaktimin e tarifave respektive te aktiviteve te energjise elektrike, vendime te cilat jane publikuar ne *Fletoren Zyrtare*.
- 2- Duhet permendur qe aplikimet e bera jane publikuar ne gazete dhe se ERE ka qene e hapur dhe ka vene ne dispozicion materialet e aplikimeve per te gjitha palet e interesuara, si dhe duke i publikuar ato edhe ne faqen zyrtare te internetit te ERE www.ere.gov.al.
- 3- Bazuar ne Vendimet e mesiperme per fillimin e procedurave te shqyrtimit te kerkesave per rishikimin e tarifave dhe cmimeve te shitjes se energjise elektrike per vitin 2011, ERE, ka pasur nje korespondence te gjere dhe intesive me keto kater shoqeri, nepermjet te ciles i eshte kerkuar paraqitja e shpjegimeve, informacioneve dhe dokumentave plotesuese lidhur me aplikimet e tyre.
- 4- Ne mbeshtetje te Rregullores se Praktikave dhe Procedurave, konkretisht te neneve 29 dhe 31 pika 1 dhe 2, te miratuar me Vendimin e Bordit te Komisionereve te ERE-s Nr.21, date 18.03.2009, nga data 25-18 Nentor 2010 si dhe me pas ne vijimesi deri me 30 Nentor 2010, midis perfaqesuesve te ERE-s dhe perfaqesuesve te KESH sh.a./FPSH, TEC Vlore sh.a, OST sh.a. dhe CEZ shperndarje., jane zhvilluar seanca degjimore teknike lidhur me shqyrtimin e aplikimeve perkatese te shoqerive per tarifat e enegjise elektrike per vitin 2011.
- 5- Ne daten 18.11.2010, ERE, organizoi seancen zyrtare publike, ne te cilen u ftuan te merrnin pjese per te diskutuar dhe shprehur qendrimet dhe opinionet e tyre lidhur me keto aplikime te gjitha institucionet, shoqat e mbrojtjes se konsumatoreve, si dhe te gjitha palet e tjera te interesuara dhe perfaqesuese te publikut te gjere, nepermjet njoftimit i cili u publikua nga ERE ne mediane dhe shkruar dhe vizive. Mendimet e paleve te shprehura ne kete seance u shqyrtuan nga Grupi i Punes i ERE-s i ngritur per kete qellim i cili nga analiza e kerkesave te shprehura nga palet e treta ne seance veren se pyetjet dhe

komentet e paleve ishin te nje karakteri te pergjithshem duke kerkuar te mos lejohet nje rritje abuzive dhe e paargumentuar te cmimeve te energjise elektrike, i cili do te rendonte padrejtesisht konsumatorët e rregullt familjare, Nje kerkese tjeter kishte te bente me ruajtjen e bandave te konsumit per konsumatorët familjare, te njejta me ato te periudhes se mepareshme. Persa me siper, grupi i punes duke vleresuar se kerkesat e paleve nuk bazohen ne llogaritje te shifrave, procedoi me studimin e aplikimeve ne perputhje me kerkesat e akteve ligjore dhe nenligjore , qe lidhen me percaktimin e tarifave dhe çmimeve sic pershkruhen ne kete relacion. Vlen ketu te permendetqendrimi i perfaqesuesit te Ministrise se Ekonomise Tregtise dhe Energjitikes ne seancen zyrtare publike, u shpreh ne parim per ruajtjen e nivelit tarifor me dy blloqe per konsumatorët familjare ç’ka eshte reflektuar edhe ne analizen e cmimeve dhe tarifave nga Grupi i Punes, duke respektuar edhe dispozitat e nenit 27 pika 1, germa dh, te Ligjit nr.9072 date 22.05.2003 “ Per sektorin e energjise elektrike”, te ndryshuar.

Pas realizimit te ketij procesi transparent, Grupi i Punes i ngritur nga ERE per shqyrtimin dhe miratimin e tarifave u mbeshtet dhe mori ne konsiderate parimet baze te vendosjes se tarifave te percaktuara ne:

- Deklaraten Rregullatore, miratuar nga Bordi i Komisionereve me Vendimin Nr. 12, date 03.03.2009,
- Vendimin nr. 46 dt.14. 06.2010 “Mbi kerkesen e OSSH sh.a lidhur me nivelin e humbjeve te energjise per vitin 2008”.
- Vendimin nr.93, date 30.11.2010 “Per miratimin e programit te uljes se humbjeve totale per tre periudhat e rregullimit”.
- Vendimin nr. 77, date 26.06.2008, te Bordit te Komisionereve te ERE-s, “Per miratimin e metodologjise se llogaritjes se tarifes per kompanine publike te gjenerimit te energjise elektrike”;
- Vendimin nr. 78, date 26.06.2008, te Bordit te Komisionereve te ERE-s, “Per miratimin e metodologjise se llogaritjes se tarifes per furnizuesin publik me shumice te energjise elektrike”;
- Vendimin nr. 59, date 29.12.2005, te Bordit te Komisionereve te ERE-s, “Per miratimin e metodologjise se llogaritjes se tarifes se transmetimit te energjise elektrike”;

- Vendimin nr. 79, date 26.06.2008, te Bordit te Komisionereve te ERE-s, “Per miratimin e metodologjise se llogaritjes te tarifes se shperndarjes te energjise elektrike”;
- Vendimin nr. 80, date 26.06.2008, te Bordit te Komisionereve te ERE-s, “Per miratimin e metodologjise se llogaritjes se tarifes per furnizuesin publik me pakice te energjise elektrike”.

Duke patur parasysh parimet e percaktuara ne aktet nenligjore te mesiperme dhe duke qene se tarifat e sherbimeve te energjise elektrike jane te transferueshme tek cmimet e shitjes me pakice per konsumatorët fundore, kerkesat e paraqitura per rishikimin e ketyre tarifave nga te kater shoqerite, u shqyrtuan njekohesisht pergjate gjithë procesit te ndjekur nga ERE.

II LLOGARITJA E TARIFAVE DHE CMIMEVE PER VITIN 2011.

II.1 BILANCI ELEKTROENERGJITIK

Ne kerkesat e paraqitura ne ERE u konstatua se te kater shoqerite nuk jane mbeshtetur ne te njejtat parashikime te kerkeses per energji elektrike per vitin 2011. Nga ballafaqimet e kryera ne seancat teknike, ERE beri me dije se baza e treguesve te bilancit energjetik mbi te cilen llogariten tarifat e sherbimeve te energjise elektrike duhet te jete e njejte. Eshte pikerisht parashikimi i kerkeses per energji elektrike, qe pergatitet nga OSSH sh.a., baza nga e cila rrjedhin dhe parashikimet e kerkeses per sistemin e transmetimit dhe te kerkeses qe duhet te permbushe FPSH ndaj FPP. Ne vijim, paraqitet bilanci energjetik i pranuar per llogaritjen e tarifave te sherbimeve te energjise elektrike per vitin 2011. Bilanci elektroenergjetik eshte ndertuar mbi bazen e roleve, pergjegjesive, dhe marredhenieve financiare te ndertuara ndermjet kater shoqerive sipas parashikimeve te Modelit Shqiptar te Tregut.

GWh	2008	2009	2010	2011
Kerkesa	4,109	4,151	4,378	4,553
Prodhimi bruto	3,720	5,192	4,267	4,250
minu konsumi vetjak	5	10	13	13
minu humbje ne prodhim	11	36	43	34
Prodhim neto	3,704	5,146	4,211	4,203
plus Prodhim nga HEC-et lokale	69	68	64	68
Shuma e Prodhimit Publik	3,773	5,214	4,275	4,271
Shitur OST per humbje	214	258	296	225
Shitur OSSH per humbje	-	286	-	-
Shitur sherbime ndihmese	-	6	-	-
Shitje/Export	59	463	-	-
Prodhimi disponibel per shitje tek FPSH	3,500	4,201	3,979	4,046
FPSH				
Prodhimi Publik	3,500	4,201	3,979	4,046
plus Prodhimi nga TEC Vlore		0	245	24
plus Prodhim nga HEC-et private	62	91	85	165
plus Importi nga FPSH	547	29	22	
import per dif te tec-it			47	
Blere nga FPSH	4,109	4,321	4,378	4,235
Shitur per FPP	4,109	4,151	4,378	4,235
	-	(170)	-	-
Energjia e levruar ne OST				
Levruar nga FPSH	4,109	4,151	4,378	4,235
Energji per humbjet e OST	214	258	296	225
Energji per humbjet e OSSH nga prodhimi	-	286	-	-
Import nga OSSH per humbje	1,927	1,947	1,705	1,547
Ekspert	59	463	-	-
levruar nga TSO per KK				300
Nga KK-Tso	11	31	100	
Shuma	6,320	7,136	6,479	6,307
OSSH/FPP				
Shitje per klientet tarife	4,109	4,151	4,378	4,235
Per Humbjet	1,927	1,947	1,705	1,547
Per KK	11	31	100	
Shuma	6,047	6,129	6,183	5,782
minus konsumi ne TL	(197)	(182)	(250)	(240)
Energjia e Levruar ne Shperndarje	5,850	5,947	5,933	5,542

**TARIFA E SHERBIMIT TE SHPERNDARJES SE ENERGJISE
ELEKTRIKE PER OSSH SH.A. PER VITIN 2011**

CEZ Shperndarje, ne aplikimin e saj te dates 1.09.2010 per tarifen e sherbimit te shperndarjes per vitin 2011 ka paraqitur nje kerkese per te ardhura prej 26,356,900 mije leke.

Tabela ne vijim paraqet ne menyre te permbledhur kerkesen e kesaj shoqerie si dhe propozimet e grupit te punes per axhustimin e zerave te vecante te te ardhurave te kerkuara :

Tabela nr 7 “Zerat e kostove dhe te ardhurat e kerkuara per shoqerine CEZ Shperndarje per vitin 2011”

	Aplikuar nga Kompania	Axhustimi ndaj propozimit te kompanise	Propozimi I ERE-s	Te ardhurat e kerkuara per vitin 2010
Kosto personeli	3,678,000		3,678,000	3,892,000
Post-telekomunikacion	97,000		97,000	83,000
Materiale	1,170,000		1,170,000	2,044,000
Riparime dhe mirembajtje	129,000		129,000	-
Trajnime , dieta	59,000		59,000	91,000
Konsulenca dhe auditime	1,104,000		1,104,000	1,683,000
Kosto sigurie	117,000		117,000	-
Shpenzime Rregullimi	18,000		18,000	-
Qera	212,000		212,000	-
Kosto te tjera	113,000		113,000	366,000
			0	54,000
Total	6,697,000		6,697,000	8,213,000
			0	
Kosto e Humbjeve	12,062,149	-395,149	11,667,000	12,539,000
			0	
Total OPEX	18,759,149	-395,149	18,364,000	20,752,000
Vlera e asetave sipas bilancit te v.2007	16,329,000		16,329,000	
Vlera e investimeve te kryera ne vitin 2008	1,953,520		1,953,520	
Asete te financuara npm Granteve	(770,000)		-770,000	
Asete te ndertuara nga KESH dhe te transferuara ne OSSH	1,100,000		1,100,000	
Vlera e investimeve te kryera per Janar-Maj 2009	3,287,206		3,287,206	
Vlera e investimeve te kryera per Qershor-Dhjetor 2009	617,654		617,654	3,098,000
Vlera e investimeve qe pritet te realizohen ne v.2010	4,540,267		4,540,267	4,340,000
Vlera e investimeve te miratuara per vitin 2011	4,896,000		4,896,000	
minus: Vlera e mesvitet te investimeve te reja te 2011	(2,448,000)		-2,448,000	
minus : Amortizimi i akumuluar	(10,212,000)		-10,212,000	
Vlera e RAB per v.2011 pa perfshire Kapitalin e Punes	19,293,647		19,293,647	
Kapitali i Punes	1,563,236	-32,903	1,530,333	1,750,000
RAB 2011	20,856,883		20,823,980	21,387,000
Norma e interesit te borxhit te vjeter	1.784%		1.784%	
Norma e interesit te borxhit te ri	10.25%		10.254%	
Kthimi i lejuar mbi kapitalin e vet	16.44%		16.44%	
Borxh i Vjeter- %	32.50%		32.50%	
Borxh i Ri - %	27.50%		27.50%	
Raporti i Synuar i Kapitalit te Vet	40.00%		40.00%	
Kthim per borxhin e vjeter	0.58%		0.58%	
Kthim per borxhin e ri	2.82%		2.82%	
Kthimi i lejuar mbi kapitalin e vet	6.58%		6.58%	
WACC	9.98%		9.98%	
Fitimi	2,080,527	-3,282	2,077,245	2,244,000
Amortizimi i Vitit	3,126,076		3,126,076	1,758,000
Te ardhura nga Lidhjet e Reja	(580,000)		-580,000	-400,000
te ardhurat nga Energjia Reaktive	(235,000)		-235,000	-240,000
Kompensimi i humbjeve dhe amortizimi 2009&2010	3,206,647		3,206,647	
Axhustimi i cmimit te energjise se blere per humbjet per v	-	-1,086,000	-1,086,000	
Kompensimi i humbjeve dhe amortizimi sipas DR		300,815	300,815	
Totali i te Ardhurave te Kerkuara	26,357,399	-1,183,616	25,173,783	
Energji e levruar ne rrjetin e shperndarjes	3,995,000		3,995,000	
Tarifa mesatare e shperndarjes	6.60		6.30	

Pas shqyrtimit te kujdesshem te kerkeses se CEZ Shperndarje (OSSH sh.a. ne momentin e aplikimit), si dhe pas sqarimeve dhe informacionit shtese te marre ne seancat teknike, grupi i punes propozon si vijon:

Vleresimi i kerkeses per te ardhura te kompanise CEZ-Shperndarje per vitin 2011.

Shpenzimet Operative (OPEX)

Sikurse verehet nga tabela e mesiperme, Shpenzimet Operative(OPEX) te kerkuara per vitin 2011, pa perfshire blerjen e energjise elektrike per mbulimin e humbjeve ne rrjetin e shperndarjes, paraqiten me ulje prej 19% krahasuar me ate te miratuar per vitin 2010. Kjo ulje e kerkeses per te ardhuar paraqitet ne zerat e shpenzimeve per paga, materiale, shpenzime per konsulence, udhetime e dieta si dhe ne zerin shpenzime te tjera.

Ne lidhje me kerkesen per te ardhuar per mbulimin e OPEX-it shpjegojme sa me poshte:

Shpenzimet per materiale dhe mirembajtjen propozohet te pranohen sipas parashikimeve te OSSH sh.a. per arsye se mirembajtja e rrjetit eshte e domosdoshme per rritjen e gadishmerise se furnizimit me energji elektrike. Nisur nga ecuria ne vite e ketyre shpenzimeve, por sidomos kundrejt vitit 2010;(2,044 milion leke) verejme se ato paraqiten me nje ulje te ndjeshme per arsye te menaxhimit me te mire te kompanise ne kete drejtim. Prandaj konsiderohete arsyeshme propozimi i paraqitur ne zerin shpenzime materiale dhe riparime e mirembajtje prej 1,299 milion leke.

Shpenzimet per paga paraqiten me nje ulje ne masen 5 % krahasuar me vleren e miratuar per kete ze ne tarifen e vitit 2010. Grupi i Punes e konsideron te arsyeshem argumentimin nga ana e kompanise per zbatimin e politikës se reduktimit te numrit te punonjesve dhe permiresimit te eficences se punes nepermjet motivimit te punonjesve me ane te rritjes se pageses, gje qe ka cuar ne reduktimin e ketij shpenzimi. Duhet theksuar se llogaritjet ne paga kane perfshire edhe indeksimin per inflacionin.

Ne tabelen me poshte jepet nje detajim i numrit te punonjeseve dhe te pages mesatare per vitet 2010-2011.

Tabela nr .8 “ Numri i punonjesve dhe kosto e pagave per vitet 2010-2011”

ALBANIA - OSSH	njesia	2010	2011	2011/2010
Numri mesatar i punonjesve	numer	5,798	4,973	85.8%
Kosto Totale e Personelit	Million leke	4,383	4,204	95.9%
Skema e re e bonuseve	Million leke	260	270	103.8%
Pagesa per lirim nga puna	Million leke	350	450	128.6%
Paga mesatare duke perfshire bonuset	Leke/muaj	57,965	62,906	108.5%
Paga mesatare duke perjashtuar bonuset	Leke/muaj	54,228	58,382	107.7%

Shpenzimet per qerate perfshijne shpenzimet per qerate :

- E magazinave te reja ne perputhje me konceptin e ri te llogjistikes, ate te centralizimit te magazinave.
- Te ambjenteve te ndryshme per zhvillimin e aktivitetit te kompanise i cili parashikon qe administrimi i kompanise te centralizohet ne Tirane. (92 milion leke)
- Te automjeteve te kompanise, per realizimin e aktivitetit te identifikimit te humbjeve joteknike si dhe te aktivitetit te arketimeve, ne vend te perdorimit te CAPEX-it te kufizuar. Me kerkesen e grupit te punes, nga kompania eshte paraqitur analiza kosto-perfitim ne lidhje me praktiken e kesaj qeramarrje.

Si rezultat i kerkesave dhe standarteve me te larta ne drejtim te permiresimit te kushteve te kryerjes se aktiviteve nga ana e kompanise, shuma prej 212 milion leke te kerkuar per kete qellim, konsiderohet e aresyeshme.

Shpenzimet per konsulenca dhe auditime perfshijne shpenzimet ne lidhje me personelin e stafit lokal, materiale, shpenzimet e IT & licensat e SAP, shpenzime per reklame, trainime, sherbime te konsulencave ligjore, si dhe pagesa ne lidhje me auditimet qe priten te kryhen per vitin 2011. Nga ana jone jane kerkuar shpjegime ne lidhje me realizimet e ketij zeri per vitin 2010, te cilat per 6-mujorin e pare rezultojne ne shumen 422 milion leke. Ky ze perfshin edhe pjesen per alokimin e te njejtij lloj shpenzimi ne zerin e shpenzimeve te perbashketa (shpenzime te pergjitheshme finance & administrate e pergjitheshme) sipas aneksit nr. 3.

Pjesa e mbetur e ketij shpenzimi shkon per aktivitetin e Furnizimit Publik me Pakice.

Nisur nga fakti i vitit 2010 si dhe i shpenzimeve te priteshme per auditimin dhe studimin mbi borxhin e keq; si dhe auditime te sistemit financiar apo te pasqyrave financiare nga ekspertet e pavarur lokale dhe nderkombetare, gjykohetqe te pranohet shuma e kerkuar nga ana e kompanise. Ky shpenzim do te jene objekt i monitorimeve nga ana e ERE-s per periudhat pasaredhese rregullatore.

Kosto per sigurine- sherbejne per mbulimin e kostove per sigurine e objekteve te tilla si nenstacione, magazinat si dhe te gjitha objektete qe i sherbejne aktivitetit te shperndarjes. Per vitin 2011 eshte paraqitur si ze i vecante per shumen 117 milion leke, qe eshte ne nivelet e vitit 2010. Nga ana tjeter konstatohet se ky shpenzim eshte i krahasueshem me ato te operatoreve te tjere .

Shpenzimet per mbulimin e humbjeve sipas kerkeses se CEZ per vitin 2011 jane paraqitur per shumen 12,062 milion leke duke perfshire dhe koston per transmetimin e ketyre humbjeve me tarife 0,6 leke/kWh.

Kerkesa e kompanise per te ardhura per prokurimin e energjise elektrike per mbulimin e humbjeve ne rretin e shperndarjes per vitin 2011 bazohet ne:

- Nivelin e humbjeve prej 27.92% ose 1547 GWh
- Cmimi i importit te energjise elektrike per 53.4 EUR/MWh
- Kursi i kembimit leke/EUR =137
- Tarifen e transmetimit 0.6 leke kWh

Nivel i humbjeve prej 27,92% i referohet reduktimit te humbjeve per vitin 2011 prej 2% ne perputhje me vendimin e Bordit te Komisionereve: Vendimin nr.93, date 30.11.2010 “ Per miratimin e programit te uljes se humbjeve totale per tre periudhat e rregullimit” kundrejt nivelit fillestar prej 29,92 % te vitit 2010 ne perputhje me piken 4.5 te Deklarates Rregullatore.

Sasia e energjise per mbulimin e humbjeve eshte llogaritur sipas formules si me poshte:

Sasia e levruar ne Shperndarje = Sasia e shitur ne shperndarje / (1 - perqindja e humbjeve)
--

(4,235 GWh -240 GWh)/(1-0,2792)=5,542 GWh

Sasia e energjise se humbur = Sasia e levruar ne shperndarje * Objektivi i humbjeve (%)

Bazuar ne tabelen e bilancit te energjise elektrike kjo sasi e energjise ne GWh eshte llogaritur si me poshte:

$$5,542 \text{ GWh} * 27.92\% = 1,547 \text{ GWh}$$

Parashikimi i cmimit te importit te energjise elektrike per mbulimin e humbjeve te energjise

Cmimet e energjise elektrike ndryshojne ne varesi te situatave ekonomike, te cilat lidhen dhe me konsumin e energjise elektrike, me cmimet e lendes se pare per prodhimin e saj si dhe te situates hidrologjike.

Parashikimet e tendecave te cmimit te energjise elektrike te bera bursa e energjise elektrike gjermane konsiderohen si te mbeshtetura dhe shfrytezohen per percaktimin e cmimit te energjise elektrike per te gjithe Europen. Gjithashtu transaksionet energjitike ne Europe bazohen ne zhvillimet e kesaj burse. Rajoni i Europes Juglindore bazohet ne kete burse, dhe ne varesi te kushteve hidrologjike dhe te CBC te disponueshme, cmimet e energjise elektrike te rajonit tone jane te krahasueshme me ato te burses gjermane. Bazuar ne faktin qe bursa gjermane eshte bursa e vetme likuide, baze edhe per rajonin tone, cmimi i energjise elektrike per vitin 2011 eshte bazuar ne kete burse per vitin 2011.

Continuous Trading | German Baseload Month Futures

Name	Best Bid	Best Ask	No. of Contr.	Last Price	Abs. Change	Last Time	Last Vol.	Settl. Price	Vol.	Vol. OTC Clearing	Open Interest	
<u>Nov-10</u>	-	-	-	-	-	-	-	49.61	-	-	-	
<u>Dec-10</u>	-	-	-	-	-	-	-	48.30	-	-	-	
<u>Jan-11</u>	-	-	-	-	-	-	-	50.28	-	-	-	
<u>Feb-11</u>	-	-	-	-	-	-	-	50.22	-	-	-	
<u>Mar-11</u>	-	-	-	-	-	-	-	48.24	-	-	-	
<u>Apr-11</u>	-	-	-	-	-	-	-	45.75	-	-	-	
<u>May-11</u>	-	-	-	-	-	-	-	43.60	-	-	-	

Continuous Trading | German Peakload Month Futures

Name	Best Bid	Best Ask	No. of Contr.	Last Price	Abs. Change	Last Time	Last Vol.	Settl. Price	Vol.	Vol. OTC Clearing	Open Interest	
<u>Nov-10</u>	-	-	-	-	-	-	-	59.62	-	-	-	
<u>Dec-10</u>	-	-	-	-	-	-	-	57.95	-	-	-	
<u>Jan-11</u>	-	-	-	-	-	-	-	61.33	-	-	-	
<u>Feb-11</u>	-	-	-	-	-	-	-	60.64	-	-	-	
<u>Mar-11</u>	-	-	-	-	-	-	-	57.48	-	-	-	
<u>Apr-11</u>	-	-	-	-	-	-	-	54.03	-	-	-	
<u>May-11</u>	-	-	-	-	-	-	-	52.38	-	-	-	

Sasia totale per tu importuar gjate vitit 2011 e shprehur ne fuqi mesatare eshte 176 MW, nga te cilat 150MW do te importohen ne bazen e grafikut me cmimin 49.746 €/MWh (sipas tenderit te organizuar nga kompania) dhe pjesa e mbetur per nje fuqi mesatare prej 26 MW parashikohet te importohet per te mbuluar ngarkesen mesatare te grafikut me cmimin 53.4 €/MWh. Si perfundim mesatarja e ponderuar rezulton 50.29 €/MWh

Sa me siper kemi bere korigjim ne zbritje per shumen 395,149 mije leke, qe i perket diferences ndermjet cmimit mesatar i importit te pranuar 50,29 Euro/MWh nga 53.4 EUR/MWh i kerkuar,

Si perfundim ky shpenzim propozohet te jete per shumen prej 11,667 milion leke nga te cilat 928 milion leke perfaqeson koston e transmetimit te energjise

Shpenzimet Kapitale (CAPEX)

Amortizimi

Persa i perket percaktimit te vleres se amortizimit qe do perfshihet ne llogaritjen e tarifes se sherbimit te shperndarjes se energjise per vitin 2011 eshte e rendesishme qe

t'i referohemi fillimisht trajtimit te kesaj ceshtje ne ne analizen dhe argumentat per tarifen e shperndarjes per vitin 2010 sipas vendimit te Bordit te Komisionereve nr 98.dt.15.12.2009. Kjo edhe per faktin se per kete ze shpenzimi nuk u gjet mirekuptimi dhe nuk u mundesua renia dakord me kompanine ne procesin e shqyrtimit te tarifes te vitit 2010. Konkretisht nga ana e kompanise amortizimi i llogaritur ishte ne vlerat 2,595 milion leke dhe 3,025 milion leke perkatesisht per vitet 2009 dhe 2010 bazuar ne vleren asetëve te trashëguar nga bilanci i meparshem dhe normat fiskale te amortizimit, sic dhe parashikohet ne metodologjine e llogaritjes se tarifes se sherbimit te shperndarjes.

Sipas Deklarates Rregullatore, niveli fillestar i vleres se Aktiveve Afatgjata eshte 16,329 milion leke, qe perfaqeson vleren kontabel te aktiveve afatgjata sipas bilancit te audituar te OSSH - 31.12.2007 ne perputhje me IFRS- te.

ERE zbatoi parimet e rregullimit, kur percaktoi amortizimin bazuar ne vleren e asetëve te njohura nga rregullatori, baze mbi te cilen llogaritet edhe norma e kthimit (WACC). Per kete arsye, vlera e amortizimit u korrigjua ne zbritje per 1,207 milion leke dhe 1,267 milion leke perkatesisht per vitet 2009 dhe 2010.

Pavaresisht diskutimeve te shumta me kompanine lidhur me kete problem per arsye te kohes se pamjaftueshme qe i duhej OSSH per te saktësuar vlerat e amortizimit si dhe mungeses se nje regjistri te plote dhe te sakte te asetëve fikse (atijet afatgjata materiale) i cili do t'i sherbente shperndarjes se vlerave te zhvleresimit ne te gjitha grupet e asetëve u vendos qe ne tarifen e vitit 2010 te pranohej korrigjimi ne ulje i bere si me siper.

Nderkohe u la e hapur mundesia qe ne periudhen e ardheshme te rregullimit te reflektohen ndryshimet ne te ardhurat e kerkuara te periudhes perkatese (nese do te kishte ndryshime).

Duke marre shkas nga kjo rrethane si dhe nga nevoja per te ndertuar nje regjister te besueshem te asetëve fikse, kompania kreu studimin per regjistrin e asetëve fikse rezultatet e te cilit i paraqiti ne ERE me shkresen nr. Nr.1510 Prot date 16.03.2010.

Studimi i cili permbledh rishikimin e dokumentacionit ekzistues, inspektimin fizik, dhe rindertimin e regjistrin bazuar ne dokumentacione teknike eshte bere me qellim qe:

- Te percaktoje Vleren e Drejte te Tregut (FM) per qellime te plotesimit te kerkesave te IFRS 3 –si rezultat kemi qe vlera e asetëve ne momentin e transaksionit eshte me e larte se vlera kontabel e tyre)
- Te percaktoje jeten e mbetur per asetet para dites se transaksionit

Pervec sa me siper me kerkesen e ERE-s kompania na ka vene ne dispozicion kopjen e listes e asetëve te OSSH ne forme elektronike (CD ROOM) qe permban te gjithë

informacionin perkates (te regjistrit te ketyre te aseteve)te perpunuar ne pasqyra Excel-i. si dhe tabelat llogaritese me te gjithe informacionin e regjistrit te perpunuar te aseteve fikse.

Grupi punes i asistuar dhe nga Kompania konsulente AEAI. Inc e angazhuar nga ana e USAID, pas nje procesi shqyrtimi dhe analize te Studimit te FAR-it te kryer nga audituesi PwC, arriti ne perfundimin qe i gjykon si realiste saktessimin e shumave te amortizimit qe do perfshihen ne llogaritjen e tarifes se shperndarjes per vitin 2011 e ne vazhdim per periudhat e ardhshme rregullatore. Konkluzionet mund te permblidhen si me poshte vijon:

- (1) Percaktimi ne Raportin e PwC i nje Vlere te drejte te Tregut (“FMV”) mund te jete i pershtatshem per qellime raportimi financiar, por jo per qellime rregullatore pasi vlere e RAB-it eshte percaktuar ne kohen qe eshte bere transaksioni 16,329 milion leke, gje qe eshte shprehur qarte ne Deklaraten Rregullatore. Percaktimi i RAB-it fillestar nepermjet rivleresimit eshte i zakonshem per ekonomi ne ristrukturim sic eshte Shqiperia. Megjithate, pergjithsisht kur ndodh rivleresimi vlerat ne bilanc per qellime rregullatore mbeten po ato dhe nuk axhustohen me rivleresimet ne vijim.
- (2) Asetet e vena ne perdorim ndermjet dates 31 Dhjetor 2007 dhe dates se blerjes se 76 % te aksioneve te OSSH nga CEZ AS duhet te regjistrohen me koston origjinale; (pra nuk ka vend per rivleresim te tyre me vlere tregu)
- (3) Perdorimi i nje sistemi per ndarjen e programit te llogaritjes se amortizimit bazuar ne ndarjen e aseteve ne dy grupe: asetet e instaluara perpara blerjes se aksioneve OSSH nga CEZ AS te amortizohen me nje jetegjatesi jo me shume se 50% te vleres se aseteve ekuivalente ne Europen Perendimore, ndersa asetet e instaluara pas blerjes nga CEZAS te kene nje jetegjatesi te ngjashme me ate te kompanive te Europes Perendimore qe jane ne te njejtat kushte;

Konkretisht vleresimi i aseteve te vjeteruar eshte llogaritur duke u bazuar ne jetegjatesine e mbetur te perdorimit e aplikuar ndaj klases perkatese respektive.

Per llogaritjen e kohes se mbetur te perdorimit te cdo klase te aseteve eshte perdorur regjistri i pronave te patundeshme qe nga dita e mbylljes se privatizimit. Mesatarja eshte llogaritur duke u bazuar ne te gjitha asetet ne klasen perkatese te aseteve qe kane daten e disponueshme te kapitalizimit.

Asetet e reja jane vleresuar me koston e tyre origjinale te blerjes (kontabilitetit) dhe jane perdorur normat fiskale per llogaritjen e amortizimit.

Bazuar ne llogjiken e mesiperme vlerat e llogaritura te amortizimit per vitet 2009, 2010, 2011 te konsideruara nga ana e kompanise ne aplikimin per tarifen e shperndarjes se vitit 2011 jane perkatesisht 2,449 milion leke, 2,622 milion leke dhe 3,126 milion leke.

Amortizimi i shtesave te aseteteve te reja eshte llogaritur ne perputhje me metodologjine e llogaritjes se tarifes se shperndarjes pra me vleren nominale kumulative te mesit te periudhes se ciles i perkasin investimet e reja.

Vlerat si me siper per vitet 2009 dhe 2010 duke qene rillogaritje, korrigojne shifrat e amortizimit te perfshire ne tarifen e miratuar nga ERE te viteve 2009 e 2010 per diferencen mes tyre dhe me ane te mekanizmit te kompensimit reflektohen ne te ardhurat totale te kompanise per vitin 2011. Efekti i kesaj rillogaritje eshte ne masen 1,061milion leke per vitin 2009 dhe 864 milion leke per vitin 2010.

Ne perfundim grupi i punes vlereson te arsyeshme perfshirjen ne te ardhurat e kerkuara per tarifen e shperndarjes te vleres se amortizimit prej 1,925 milion leke si kompesim per amortizimin e vitit 2009 dhe 2010.

Llogaritja e RAB dhe llogaritja e Kosmos Mesatare te Ponderuar te Kapitalit (WACC) per vitin 2011 mbeshtetet ne percaktimin e bere ne metodologji dhe ne deklaraten rregullatore.

Ne tabelen e paraqitur me siper jepen elementet perberes te formulave te llogaritjes se ketyre komponenteve.

Kapitali i Punes

Kapitali i Punes eshte korigjuar ne zbritje per vleren 32.9 milion leke per vitin vitin 2011, korigjim i cili eshte rezultat i korrektimit te shpenzimit te blerjes se humbjeve sic edhe u pasqyruara me siper per OPEX-in.

WACC

Llogaritja e kosmos mesatare te ponderuar te kapitalit(WACC) nga kompania eshte paraqitur sipas formules te miratuar ne Deklaraten Rregullatore.

Referuar metodologjise se tarifave per aktivitetin e shperndarjes instrumenti i borxhit lejohet vetem per financimin e aktiveve afatgjata (investimet), dhe ky shpenzim do te konsiderohet i arsyeshem vetem nese kompania ka vepruar sipas rregullores “procedurat e financimit te kredise nga OSSH”, miratuar nga Bordi i Komisionereve .

Lidhur me kete komponente, kompania ka paraqitur si fakt nje “Mandat Leter” te IFC & EBRD-se . Mendojme qe normat e interest te percaktuara ne kete kerkese (si edhe ndertimi i tyre sipas zerave) jane ne perputhje me normat gjeresisht te pranueshme ne treg, kjo sipas te dhenave te publikuara ne internet ne adresat e meposhtme:

<http://www.stern.nyu.edu/Search/index.htm>

http://sdw.ecb.europa.eu/quickview.do?SERIES_KEY=143.FM.M.U2.EUR.RT.MM.EURIBOR6MD.HSTA (Bashkangjitur kini edhe materialet e printuara per kete qellim).

Nga diskutimet ne seancat teknike perfaqesuesit e CEZ Shperndarje sh.a jane shprehur se ata i jane drejtuar bankave lokale “Raiffeisen” dhe “Société Générale” dhe me pas IFC & EBRD-se per huadhenien e 100 milion EUR.

Duke qene se interesat qe ofrohen nga dy institucionet financiare nderkombetare te mesiperme jane me te ulta se interesat e bankave lokale tregtare dhe per faktin se ne Deklaraten Rregullatore parashikohet qe OSSH mund te marre kredi nga keto institucione pa ju nenshtruar procedurave tenderuese. Grupi i punes, gjykon te pranoje si kosto te kredive te reja ate ate ofruara nga EBRD & IFC.

Ne aplikim jane paraqitur kushtet dhe kostot shoqeruese te kredive te reja .

Ne perlllogaritjen e koston se borxhit jane pranuar kosto e borxhit te vjeter 1.784% dhe kosto e borxhit te ri 10.254%.

Kthimi mbi RAB-eshte llogaritur konform metodologjive dhe rezulton 2,077 milion pra 3.28 milion leke me pak nga ai i kerkuar, per shkak te korigjimeve te bera nga grupi i punes per kapitalin e punes.

Axhustimi i koston se energjise elektrike per mbulimin e humbjeve per vitin 2009 dhe 2010 :

- Ne llogaritjen e tarifes se shperndarjes eshte bere korigjimi ne rritje per shumen 1,277 milion leke per shkak te korigjimit te nivelit te pranuar te humbjeve te vitit 2009 dhe 2010 sipas vendimit te bordit te Komisionereve nr 46 dt 14.06.2010
- Nga ana grupit te punes, ne te njejten kohe eshte bere korigjimi ne zbritja e te ardhurave te kerkuara totale per shumen 1,086 milion leke. Kjo diference, e cila nuk ishte llogaritur nga kompania, vjen si rezultat i diferences se cmimit aktual te blerjes me cmimin e planifikuar ne tarifen e miratuar per vitin 2009 (nga 43EUR/MWh ne 42,43 EUR/MWh) dhe

2010 (nga 50 EUR/MWh ne 45,5 EUR/MWh). Respektivisht per vitin 2009 kjo shume rezulton 154 milion leke dhe per vitin 2010 llogaritet ne zbritje per 932 milion leke.

Ne perfundim propozohet, qe per vitin 2011 te ardhurat e kerkuara te kompanise per aktivitetin e shperndarjes te pranohen ne shumen 25,173 milion, nderkohe qe tarifa e sherbimit te shperndarjes per vitin 2011 te **jete 6,30** leke/kWh.

II.2 TARIFA E SHERBIMIT TE FURNIZIMIT ME PAKICE (FPP) TE ENERJISE ELEKTRIKE PER VITIN 2011

Shpenzimet qe lidhen me veprimtarine e shitjes me pakice te propozuar ne aplikimin per tarifen e vitit 2011 nga ana e CEZ Shperndarje, ne funksionin e FPP, jane paraqitur ne vleren 1,875 milion leke. Shpenzimet per borxhin e keq jane parashikuar ne nivelin 12% sic e parashikon Deklarata Rregullatore per vitin 2011

Tabela ne vijim paraqet shpenzimet, kerkesen per te ardhura te aktivitetit te FPP per vitin 2011 si dhe propozimin e ERE-s.

Tabela nr.8 “: Kostot dhe te ardhurat e kerkuara nga ana e FPP (000 Leke)’

Item	aplikuar nga Kompania	axhustime ndaj propozimit te kompanise	Propozimi I kompanise	2010
Kosto Personeli	505,601		505,601	491,000
Post-Telekomunikacion	720,787		720,787	9,000
Materiale			0	
Riparime dhe mirembajtje			0	
Trajnime dhe Dieta	20,881		20,881	10,000
Konsulence dhe auditime	38,983		38,983	
Kosto per sigurine	242,933		242,933	
Penalitetet, gjoba dhe deme			0	41,000
Qera	54,568		54,568	187,000
Te tjera	63,290		63,290	36,000
			0	
Alokimi i shpenzimeve te pergjithshme dhe admi	228,449		228,449	-
Total	1,875,492		1,875,492	-
Total OPEX	1,875,492		1,875,492	774,000
Tarifa e blerjes se energjise nga FPSH Lek/KWH	2.03		1.48	2.03
Blerjet e energjise nga FPSH- GWH	4,139		4,235	4378
Kosto totale e blerjes se energjise nga FPSH - Lek	8,402,170	-2,123,448	6,278,722	8,868,000
Norma e fitimit te FPSH %	2.20%		2.20%	2.20%
Fitimi	184,848	-46,716	138,132	195,096
Kerkesa per te ardhura e OST	2,483,756	57,371	2,541,127	2,640,000
Kerkesa per te ardhura e OSSH	26,356,900	-1,183,117	25,173,783	24,112,000
Shpenzime te Borxhit te Keq te periudhes se mep	1,460,864	-1,460,864	-	0
Shpenzime Borxhi te Keq	4,694,198	-373,327	4,320,871	4,756,000
shpenzime per borxhin e keq per energjine reaktive		28,200	28,200.00	
				379,000
Te Ardhurat e Kerkuara Totale te FPP	45,458,228	-5,101,902	40,356,327	41,724,096
Shitjet e energjise	4,139,000		4,235,000	4,378,000
Cmimi mesatar per konsumatorin tarifore	10.98		9.53	9.53
	15%		10%	

OPEX

Totali i OPEX-it ne vleren 1,875 milion leke te kerkuar per aktivitetin e FPP shenon nje rritje te konsiderueshme krahasuar me ate te vitit 2010 , si pasoje e rishperndarjes se shpenzimeve te perbashketa administrative te shpjeguar ne aneksin nr.3 te aplikimit. Sic tregohet nga tabela me siper, ndikimi kryesor kane shpenzimet per post-telekomunikacion, shpenzimet e sigurise (ruajtjes se objekteve).

Nisur nga aplikimi i kompanise dhe shpjegimet e bera ne seancat teknike shpjegojme sa me poshte jepen dhe analizohen zerat e vecante te OPEX-it:

- *Shpenzimet postare* ne shumen 720 milion leke jane argumentuar me aplikimin e sherbimit postar te shperndarjes se faturave me zarfa te mbyllur tek cdo klient. Kosto e ketij sherbimi llogaritet mbi bazen e tarifes 3 leke per cdo fature dhe numrit te pergjithshem te klienteve.
- Norma e fitimit te FPP e llogaritur nga kompania e marre 2.2% te shpenzimeve te blerjes se energjise nga FPSH bazuar ne FPP dhe Deklaraten Rregullatoreeshte paraqitur ne aplikim ne shumen 184 milion leke. Si rezultat i tarifes se re (cmimit te ri) me te ulet te propozuar per energjine qe do te shitet nga FPSH per FPP gjate vitit 2011 rezulton nje reduktim prej 47 milion lekesh, per aktivitetin e shitjes me pakice te energjise duke e cuar ate ne vleren 137 milion leke per vitin 2011.
- Shpenzimet e rritura te sigurise se objekteve ne vleren 243 milion leke kane te bejne me forcimin e masave te sigurise ne menyre te vecante ne qendrat e kujdesit ndaj konsumatorit per te mbuluar me mire problemet e arketimit te parave me bokse sigurie, kamera vezhguese, roje per transfertat e parave etj. Per vitin 2011 eshte kerkuar si ze i ri i vecante, sepse per vitin 2010 ky shpenzim eshte paraqitur si shpenzim i perbashket me ate te aktivitetit te shperndarjes Me argumentimin e mesiper keto kosto propozohen te konsiderohen te arsyeshme per kryerjen ne kushte normale aktivitetit te FPP.
- Alokimi i shpenzimeve te pergjithshme dhe administrative ne shumen prej 228 milion leke eshte bere mbi bazen e faktorit te alokimit te llogaritur nga kompania i cili eshte percaktuar nisur nga ndarja e kostove te administrates se pergjithshme ndermjet aktivitetit te shperndarjes dhe FPP. Ky koeficient eshte 12.52% per aktivitetin e furnizimit. Ne kete menyre totali i shpenzimeve te pergjithshme prej 1,825 milion leke i shperndahet FPP ne vleren 228 milion leke bazuar ne faktorin e siperpermendur te alokimit. Keto shpenzime ne vitin 2010 jane paraqitur si ze total i koston se aktivitetit te shperndarjes ne

pamundesitë të ndarjes së tyre sipas aktiviteteve për mundësi eksperimentale dhe historike.

- Në kërkesën e saj kompania ka përlogaritur Borxhin e Keq në shumën 4,694 milion lekë. Duhet theksuar se në lidhje me këtë, nga kompania është kërkuar që të ndryshojë formulën e llogaritjes së borxheve të keqja nga ajo e përdorur nga ERE për vitin 2009 dhe 2010, me pretendimin se zbatimi i formulës në fjalë i jep kompanisë me pak të ardhura (rreth 430 milion lekë).

Në lidhje me këtë pretendim kompania i është referuar pikës 5.2 të Deklaratës Rregullatore, duke konsideruar si të ardhura të kërkuara të ardhurat e përgjithshme të kompanisë, pra të ardhurat nga shitja.

Grupi i punës mban të njëjtin opinion në lidhje me aplikimin e formulës, të njëjtit me atë të vitit 2010, me sqarimin se në pikën 5.2 të DR përcaktohet se: *borxhi i keq i lejuar do të llogaritet si një përqindje mbi shumën e të ardhurave totale të OSSH në funksionin e saj si FPP përfshirë të gjithë përberësit e tarifave të FPSH (përfshirë atë të prodhimit, OST, DSO, PSO, FPP dhe pagesa të tjera sipas rastit duke përjashtuar tatimin mbi vlerën e shtuar (Te ardhurat e FPP) ...dhe jo sipas pretendimit të kompanisë se debitoret e keqinjtë llogariten në përqindje të të ardhurave nga shitja (të të ardhurave të përgjithshme).*

Në vijim të këtij pretendimi kompania ka kërkuar dhe kompesimin për vitin 2009 dhe 2010 të diferencave në llogaritje (sipas formulës të paraqitur) shumën 1,460 milion lekë. Për të njëjtin arsye siç shpjeguar më lart mbajmë të njëjtin qëndrim.

Si konkluzion grupi i punës propozon që për vitin 2011 kompanisë CEZ Shpërndarje t'i njihen të ardhurat e kërkuara për aktivitetet e furnizimit shuma prej 40,356 milion Lekë, që i korrespondon një tarife **9,53 lekë/kWh**.

Struktura e tarifave

Megjithatë në aplikim kompania ka propozuar një strukturë tarifë të ndryshme nga ajo e vitit 2010, duke përfshirë komponente të tarifës fikse dhe variabël për aktivitetin e furnizimit dhe të shpërndarjes, por për arsye se cmimi mesatar i propozuar nga ana jonë për vitin 2011 rezulton i njëjtit me atë të vitit 2010 jemi të mendimit që të aplikohet e njëjta strukturë tarifash për çdo grup të klienteve tarifore si ajo egzistuese. Tabela e mëposhtme paraqet strukturën e tarifave të furnizimit të energjisë elektrike me pakice, për çdo grup klientesh, sipas nivelit të tensionit si dhe tarifën e pikut dhe tarifën perkatese të energjisë reaktive.

Tabela: Struktura e tarifave të furnizimit të energjisë elektrike

Cmimet e shitjes me pakice per konsumatorët tarifore, te miratuar nga ERE per periudhen 1 Janar - 31 Dhjetor 2011

Niveli i Tensionit	Kategorite e Konsumatoreve	Viti 2011			
		Cmimi (leke/kWh)	Cmimi I energjise ne pik (leke/kWh)	Cmimi I energjise reaktive (leke/kVAr)	
TENSIONI I LARTE	Kliente te Transmetimit TL me asetë te zoteruar prej tyre				
	Industri	6.20	6.51	0.93	
	Tregeti & sherbime				
	Bujqesi				
	Te tjere				
	Kliente te furnizuar ne N/S 110 kV te shperndarjes				
	Industri	8.00	8.40	1.20	
	Tregeti & sherbime	8.00	8.40	1.20	
	Bujqesi	8.00	8.40	1.20	
	Te tjere	8.00	8.40	1.20	
TENSIONI I MESEM	Kliente te furnizuar ne 35 kV				
	Industri	8.50	8.93	1.28	
	Tregeti & sherbime	8.50	8.93	1.28	
	Bujqesi	8.50	8.93	1.28	
	Te tjere	8.50	8.93	1.28	
	Kliente te furnizuar ne 20/10/6 kV				
	Industri	9.10	9.56	1.37	
	Tregeti & sherbime	10.00	10.50	1.50	
	Furra buke, prodhim mielli	7.10	7.46	1.07	
	Bujqesi	8.70	9.14	1.31	
	Te tjere	9.70	10.19	1.46	
	Buxhetore	11.50	12.08	1.73	
	TENSIONI I ULET	Kliente te furnizuar ne TU			
		Industri	10.50		
Tregeti & sherbime		12.20			
Furra buke, prodhim mielli		7.60			
Bujqesi		10.50			
Te tjere		12.00			
Buxhetore		14.00			
Familjare					
Biloku I pare deri ne 300 kWh		7.70			
Biloku I dyte mbi 300 kWh		13.50			
Tarifa fikse e sherbimit te furnizimit per leximin "zero" (leke/muaj)		200			
Tarifa per konsumin e energjise elektrike ne ambientet e perbashketa (shkalle, pompe, ashensor, etj (leke/kWh)		8.00			
Mesatare Totale		9.53			

Eshte shume e rendesishme te theksohet se meqe propozohet qe struktura e tarifave te mbetet e njejte si ne vitin e kaluar, por ne dallim nga viti i kaluar tarifa e pikut propozohet te jete ne masen 5% me e larte se tarifa baze e energjise per cdo grup klientesh per vitin 2011. Kjo arsyetohet me argumentin qe sistemi elektroenergjetik shqiptar eshte i bazuar mbi HEC-e dhe kosto e mbulimit te pikut nga keto centrale eshte me e vogel se kosto e importit si dhe ne te njejten kohe cmimi i importit, i cili ka sherbyer si refernce per llogaritjen tarifes se pikut, per vitete 2009 dhe 2010 ka pesuar rnie duke rezultuar edhe me i ulet se cmimet e energjise per grupet e klienteve . Persa me siper duke u mbeshtur edhe ne gjendjen aktuale, per pamundesise objektive te sigurimit te dhenave te konsumit ne pik dhe jashte pikut, si pasoje e mungeses se matjes per te gjitha klientet tarifor, ne vitin 2011 do te realizohet nje studim i profilit te ngarkeses, i cili do te mundesoje llogaritjen e sakte te tarifes te pikut. **Per sa me siper ERE i ka lene detyre kompanise CEZ Shperndarje te kryej brenda 6-mujorit te pare te vitit 2011 kete studim dhe ta paraqese per aprovim prane ERE-s, studim i cili do te sherbeje si baze per vendosjen e tarifave te cdo grup klientesh tarifor sipas niveleve te tensionit, per vitin 2012.**

Persa lidhet me tarifat me dy blloqe per klientet familiar propozojme qe te vazhdojne te ekzistojne edhe per vitin 2011 me arsyetimin se kjo strukture dekurajon shfrytezimin e energjise elektrike per ngrohje dhe gatim. Keto dy sherbime fare mire mund te garantohen nga burime alterantive me kosto konkurruese. Gjithashtu mbajtja e nje strukture te tille eshte kerkuar me kembengulje dhe nga te gjitha palet e interesuara: Shoqata e Konsumatoreve, Avokati i Popullit, METE, etj shprehur secila ne ne seancen publike degjimore te dates 18.11.2010.

Per pasoje duke reflekuar situaten e re te krijuar reduktimi i tarifes se pikut reflekton me mire realitetin dhe koston e sherbimit perkundrejt ketyre konsumatoreve.